


16 prill 2025

Rajoni i Euroazisë



Italia

Italia ka qenë gjithmonë e rëndësishme në peizazhin gjeografik European, për shkak të vendndodhjes së saj qendrore në pjesën jugore të Europës. Për gati 800 vjet, Perandoria Romake sundoi pjesën më të madhe të botës së njohur, por ra në shekullin e 5-të nën pushtimet e shumë prej fqinjëve që kishte sunduar dikur. Për shekuj ajo ishte një enigmë e mbretërive të vogla të pavarura ose qytet-shtete, por në 1861, u bë një komb ku shtetet e tij u bashkuan. Në Luftën e Parë Botërore, Italia luftoi në anën e fuqive Aleate për të rivendosur rendin në Europë, por në Luftën e Dytë Botërore, ajo zhvilloi luftë kundër forcave Aleate në promovimin e një regjimi fashist nën udhëheqjen e Benito Musolinit. E mposhtur, Italia filloi të shfaqej ekonomikisht dhe socialisht, dhe politikisht u bë një republikë demokratike në vitin 1946. Vetëm dy vjet më vonë, Kisha e Nazaretasit hyri në Itali për të filluar zyrtarisht punën e saj atje në vitin 1948. Një vend me mbizotërim Katolik Romak, puna e besimeve ungjillore protestante ka qenë e ngadaltë në zhvillim. Megjithatë, Kisha e Nazaretasit nuk është vetëm e pranishme, por e qëllimshme në përpjekjet e saj për të ndarë Lajmin e Mirë të Jezusit dhe për të përhapur mesazhin e shenjtërisë së shkrimeve të shenjta. La famiglia (familja) është e rëndësishme për kulturën Italiane dhe nëpërmjet kishës, La famiglia merr kuptim dhe gjerësi të re.



336 Anëtarë



6 Kisha plotësisht të
organizuara



3 Shërbëtorë të liçensuar
dhe 8 Shërbëtorë të
Shuguruar në 1 Distrikt

LUTJE



- Lutuni për punën në zhvillim në Moncaliari, Itali nëpërmjet blerjes së Fugonit të ri të Solidaritetit Ushqimor dhe për dyert e hapura që po krijon.
- Lutuni për ata, jeta e të cilëve po ndikohet ndjeshëm nga kjo shërbesë e re që trajton pasigurinë ushqimore në zonë, si dhe një dëshmi e gjallë e kujdesit në komunitet.

LAVDËRIM



- Lavdëroni Zotin për kontaktet e reja dhe zgjerimin e ndikimit nëpërmjet komunitetit të kujdesshëm në Moncaliari.
- Lavdëroni Zotin për Nazaretasit besnikë që kontribuan në këtë projekt nëpërmjet lutjes, financave dhe shërbimeve vullnetare. Çfarë gëzimi të jesh pjesë e familjes globale Nazaretase!

Një Shikim i Shpejtë MNN



Fugoni i Solidaritetit Ushqimor bën Ndryshim në Itali



Nazaretasit kanë ndikuar ndjeshëm në Moncalieri duke financuar një projekt të veçantë të quajtur "Fugoni i Solidaritetit Ushqimor". Si rezultat, një makinë e re është blerë për të lehtësuar përpjekjet për dhurimin dhe shpërndarjen e ushqimit të menaxhuara nga kongregacioni i Nazaretasve vendas. Shtimi i këtij automjeti ka transformuar thellësisht logjistikën e shpërndarjes së ushqimit në zonë, duke rritur në masë të madhe aftësitë e kontaktit të kongregacionit.



Një vullnetar shprehu mirënjohjen për kontributet bujare që bënë të mundur këtë projekt, duke thënë: “Marrja dhe transporti, i cili dikur kryhej me automjetet tona personale, është bërë dukshëm më i shpejtë me automjetin e ri; në vend të disa udhëtimeve dhe ngarkimit manual, tani është e mundur që të ngarkohen drejtpërdrejt paletat e produkteve ushqimore dhe të lejojë dikë tjetër të kryejë tashmë renditjen midis udhëtimeve ”.

Automjeti i ri jo vetëm që ka përmirësuar efikasitetin e shpërndarjes së ushqimit, por gjithashtu ka rritur aftësinë e kishës për t'u lidhur me komunitetin. Një vullnetar tjetër ndau: "Zoti iu përgjigj lutjeve tona, duke na bekuar me këtë furgon, të cilin shpresojmë ta mbushim gjithnjë e më shumë; kjo na jep gjithashtu mundësinë jo vetëm të shërbejmë ushqim, por të dëshmojmë për praninë e Kishës në lagje, por mbi të gjitha të flasim për Jezusin. Dëshmia e mirë që japim bën që disa njerëz të na pyesin pse përfshihemi në këtë shërbesë; ata janë të intriguar nga komuniteti ynë, dhe gjithashtu nëpërmjet mbledhjeve të tjera, ne vërtet arrijmë të dëshmojmë për komunitetin tonë ."



Ky projekt, si shumë të tjerë të angazhuar nga kongregacionet Nazaretase anembanë botës, ilustron se si shërbimi në komunitet dhe shtrirja shpirtërore shkojnë paralelisht, duke shfaqur angazhimin e Kishës së Nazaretasit për të përmbushur nevojat fizike dhe shpirtërore. Së bashku, ne vazhdojmë të dëshmojmë fuqinë transformuese të hirit të Perëndisë në jetën e individëve dhe familjeve në Moncalieri.

[A mund të shërbeni?](#)

A po ju thërret Zoti që të bashkoheni në misionin e Tij në Rajonin e Euroazisë? Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF.

Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).



17001 Prairie Star Pkwy
Lenexa, KS | 66220 US



KISHA e
NAZARENIT